



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 10 prill 2013

Nr. i lëndës 2011-07

W

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 10 prill 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e cila së fundi ka pësuar ndryshime më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 11 prill 2011. Më 25 nëntor 2011 Paneli ka kërkuar informata shtesë nga Shefi i Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë. Kjo informatë është pranuar më 19 janar 2012.
2. Më 20 mars 2012, Paneli ka vendosur ta njoftoj ShM rreth ankesës, duke ftuar atë që të parashtrij vërejtjet e tij më shkrim lidhur me ankesën. Vërejtjet e ShM janë pranuar më 4 maj 2012, ku më pas ato

ishin përkthyer dhe dërguar parashtruesit të ankesës për vërejtje shtesë.

3. Më 16 qershor 2012, parashtruesi i ankesës është takuar me Sekretariatit e Panelit dhe ka paraqitur gojarisht vërejtjet shtesë.
4. Më 5 tetor 2012, Paneli ka shpallur ankesën pjesërisht të pranueshme. Paneli ka gjetur se ankesa ka ngritur çështje serioze të faktit dhe ligjit sipas nenit 3 (liria nga tortura, trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruar) dhe nenit 8 (respektimi i jetës private) i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Konventa) përcaktimi i të cilave ka kërkuar që të shqyrtohen meritat e ankesës. Më tej, Paneli ka gjetur ankesën të papranueshme sa i përket nenit 2 të Konventës (e drejta për jetë). Paneli ka ftuar palët që të parashtrorjnë ndonjë vërejtje shtesë që ata kishin rreth meritave të rastit.
5. Gjithashtu Paneli ka vendosur se masat e përkohshme të paraqitura në vijim, të cilat ishin miratuar sipas Rregullës 22 të Rregullores së Punës duhet të zbatohen nga EULEX-i:
 1. Prokurorët e EULEX-it të ngarkuar me këtë lëndë duhet të ftohen që t'ju kërkojnë kolegëve të tyre serb që t'ju kthejnë kopjet e secilit dokument që ju ishte ofruar atyre, e që e mbajnë emrin apo që ju referohet parashtruesit të ankesës. Kjo do të përfshinë dy deklaratat që i ka dhënë parashtruesi i ankesës EULEX-it.
 2. Prokurorët e EULEX-it të ngarkuar me këtë lëndë duhet të ftohen që të t'ju kërkojnë kolegëve të tyre serb si në vijim:
 - i. Të asgjësojnë secilën kopje të bërë nga dokumentet e lartpërmendur dhe ta heqin emrin dhe secilën informatë në dokumentet e tjera që mund të identifikoj parashtruesin e ankesës; dhe
 - ii. Të njoftoj prokurorët e EULEX-it se kjo gjë është kryer; dhe
 - iii. Mos t'i zbulohet asnjë informatë që parashtruesi i ankesës i kishte ofruar EULEX-it ndonjë të dyshuari apo të pandehuri.
6. Më 17 janar, përkatësisht më 10 shkurt 2013 janë pranuar vërejtjet nga ShM dhe nga parashtruesi i ankesës.
7. Me qëllim të mbrojtjes së privacisë, sigurisë dhe identitetit të parashtruesit të ankesës, Paneli ka vendosur, *proprio motu (me vetë iniciativë)* që ta vendos emrin e parashtruesit të ankesës si anonim. Ai do të referohet si W.

II. FAKTET

RRETHANAT E RASTIT

8. Faktet e lëndës, ashtu siç janë parashtruar nga parashtruesi i ankesës, dhe siç paraqiten nga dokumentet në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si në vijim.

Të dhënat paraprake

9. Sipas parashtruesit të ankesës, ai dhe disa fshatarë të tjerë ishin dëshmitarë të vrasjes së 109 civilëve nga forcat serbe gjatë tri incidenteve të ndara në fshatin Lubeniq, në zonën e Pejës, midis muajt maj 1998 dhe prill 1999.

Hetimi nga EULEX-i

10. Parashtruesi i ankesës dhe një numër i personave të tjerë janë takuar me udhëheqësin e ekipit të njësisë për hetimin e krimeve të luftës së EULEX-it (më tutje: hetuesi i EULEX-it) për herë të parë në muajin maj të vitit 2010 në lidhje me hetimin e këtyre incidenteve. Pas kësaj kanë pasuar disa takime të tjera, disa takime me ekipin e njësisë për hetimin e krimeve të luftës së EULEX-it dhe disa takime të tjera me zyrën e prokurorit special të Kosovës (PZPSK).
11. Në këtë kontest, parashtruesi i ankesës dhe persona të tjerë kanë ofruar disa deklaratat tek hetuesit e EULEX-it. Parashtruesi i ankesës ka ofruar deklaratën e tij të parë më 20 korrik 2007 dhe një deklaratë tjetër më të zgjeruar më 27 korrik 2010. Të dhënat e deklaratave nuk tregojnë se parashtruesi i ankesës ishte njoftuar se dëshmia e tij dhe të dhënat e tij të kontaktit mund t'ju shpërndareshin autoriteteve serbe.
12. Gjatë një takimi vijues me hetuesit e EULEX-it, personave të cilët kishin dhënë deklaratat në lidhje me ato ngjarje supozohet se ju ishte thënë nga hetuesit e EULEX-it se hetimi nga ana e EULEX-it do të përfundoj së shpejti dhe se ndjekja penale e rastit mund të merrej përsipër nga ana e autoriteteve serbe. Dëshmitarët kundërshtuan një veprim të tillë dhe kërkuan që hetimi të kryhej nga EULEX-i. Paneli nuk është në dijeni rreth ndonjë përgjigje, nëse ka pasur ndonjë, nga hetuesi i EULEX-it ndaj këtyre kundërshtimeve.
13. Gjatë gjithë hetimit nga hetuesit dhe prokurorët e EULEX-it, parashtruesi i ankesës dhe dëshmitarët e tjerë kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me EULEX-in. Sidoqoftë, ata kanë kundërshtuar që të lejohej dërgimi i deklaratat e tyre tek autoritetet serbe, për shkak të shqetësimit që lidhej me sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre.
14. Më 30 mars 2011, pesë persona të cilët i kishin dhënë deklaratat në EULEX kërkuan t'i tërheqin deklaratave të tyre. Për atë qëllim në kërkesën e tyre ata shprehën mosbesimin e tyre në EULEX, pasi që

dysshohej se po bashkëpunonte me autoritetet serbe. Parashtruesi i ankesës nuk ishte në listën e emrave të atyre pesë personave.

15. Në tetor 2011, të njëjtët persona të cilët kishin kërkuar tërheqjen e deklaratave të tyre ishin kontaktuar nga EULEX-i. Ata e drejtuan EULEX-in tek parashtruesi i ankesës. Një takim ishte dashur të mbahej në tetor të vitit 2011 në mes të EULEX-it dhe parashtruesit të ankesës, mirëpo ai takim nuk ishte mbajtur. Nuk janë sqaruar arsyet për këtë.
16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i ankesës ka kontaktuar me Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës rreth dërgimit të deklaratave të tij autoriteteve serbe nga EULEX-i. Në kërkesën e tij drejtuar Avokatit të Popullit, parashtruesi i ankesës ka treguar se EULEX-i fillimisht kishte marrë përsipër se kjo lëndë do të procedohej në Kosovë para se të njoftohej *post factum* (pasi që ishte kryer akti) se deklaratat e tij i ishin dërguar autoriteteve serbe.

Informata shtesë të marra nga EULEX-i

17. Paneli ka pranuar informata kundërtënëse nga EULEX-i lidhur me natyrën e hetimit të këtij rast. Në përgjigjen fillestare të pranuar më 17 janar 2012, Paneli ishte njoftuar se hetimi në mes të EULEX-it dhe autoriteteve serbe ishte hetim "i përbashkët". Më vonë ajo informatë ishte tërhequr dhe në vend të saj Paneli ishte njoftuar se ka pasur dy hetime (një hetim nga EULEX-i dhe një hetim nga autoritetet serbe) dhe se ka pasur bashkëpunim *joformal* në mes të EULEX-it dhe autoriteteve serbe në lidhje me rastin.

Dëshmia e parashtruesit të ankesës në Serbi

18. Në vërejtjet e tij rreth meritave të ankesës, ShM ka njoftuar Panelin rreth zhvillimeve të mëtejme të rastit.
19. Në një datë që nuk është saktësuar, Zyra e Prokurorisë për krime të Luftës të Serbisë ka kërkuar që disa persona, në mesin e tyre edhe parashtruesi i ankesës, të ofroj dëshmi në një hetim që është zhvilluar nga autoritetet serbe. Më 4 shtator 2012, parashtruesi i ankesës dhe tre dëshmitarë të tjerë, së bashku me zyrtarët e Njësisë së Hetimit të Krimeve të Luftës së EULEX-it kanë udhëtuar në Kurshumli, Serbi dhe kanë dhënë dëshmi rreth masakrës së dyshuar, e cila kishte ndodhur në Lubeniq më 1 prill 1999. Në bazë të kësaj, ShM ka sugjeruar që parashtruesi i ankesës efektivisht ishte pajtuar që përmbajtja e deklaratës së tij t'i dërgohej autoriteteve serbe dhe prandaj nuk kishte arsye të tjera për ankesë. ShM nuk e ka saktësuar se çfarë masa mbrojtëse, nëse ka ndonjë, ishin kërkuar apo ofruar për ta mbrojtur identitetin dhe/apo origjinën e kësaj informate në kontekst të dhënies së dëshmisë si pjesë e këtyre procedurave.
20. Parashtruesi i ankesës ishte ftuar që të parashtroj vërejtje të tjera lidhur me këtë informacion, në veçanti nëse ai vazhdon me ankesën e tij kundër EULEX-it. Në parashtrimet e tij të tjera të datës 10 shkurt 2013, parashtruesi i ankesës ka treguar se ai vazhdon me ankesën e

tij. Ai gjithashtu duket se sugjeron se marrëveshja e tij për të siguruar informacione në lidhje me persona, të cilët aktualisht ishin në paraburgim në Serbi nuk përbënte ndonjë miratim gjithëpërfshirës – *ex post facto* se deklarata e tij mund t'ju dërgohej autoriteteve serbe për çfarëdo lloj përdorimi apo qëllimi.

III. ANKESAT

21. Parashtruesi i ankesës pretendon se EULEX-i i ka shkelur të drejtat e tij të përcaktuara në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventën) duke i dërguar deklaratat e tij autoriteteve serbe, kundër vullnetit të tij dhe pa bazë ligjore. Më tutje ai deklaron se ndihet i kërcënuar, pasi emri i tij tashmë ju është zbuluar autoriteteve serbe, të cilëve ai nuk ju beson.

IV. SHQYRTIMI PARAPRAK: MOS ZBATAIMI I MASAVE TË PËRKOSSHME NGA EULEX-i

22. Siç vihet në dukje më lart, në vendimin e papranueshmërisë, Paneli e kishte ftuar ShM që të zbatoj një numër të masave të përkohshme sipas nenit 22 të rregullores së punës. Në dokumentet e parashtruara të datës 8 janar 2013, ShM ka treguar se sipas pikëpamjes së EULEX-it masat e përkohshme nuk kanë ndonjë efekt praktik, pasi që çfarëdo dëmi që është shkaktuar nga zbulimi i këtij informacioni tashmë vetëm se kishte ndodhur dhe në bazë të kësaj ai e hodhi poshtë zbatimin e masave të përkohshme të propozuara.
23. Duke vepruar kështu, EULEX-i duket se e ka keqkuptuar natyrën dhe seriozitetin e ndërhyrjes shkaktuar në të drejtën e parashtruesit të ankesës dhe ka mundur që ta ketë nënvlerësuar nevojën për të vepruar urgjentisht për të penguar një dëm më të madh. Siç diskutohet më poshtë, paragjykimi që i është shkaktuar parashtruesit të ankesës nga zbulimi i informatës së ndjeshme është real, serioz dhe i vazhdueshëm. Secila kopje e deklaratës së tij e bërë dhe e shpërndarë mund të bie në “duar të gabuara”. Vendimi i Panelit për të ftuar ShM që t'i ndërmarr masat e përkohshme është dashur që të jep një shenjë të qartë rreth nevojës që të veprohet shpejtë në mënyrë që të shmanget konkretizimi i rrezikut. Masat e përkohshme kanë një qëllim mbrojtës, ato kanë për qëllim të pengojnë shfaqjen potenciale të shkeljeve të të drejtave të njeriut, apo përndryshe t'ju qasen situatave ekzistuese që kanë gjasa të kenë ndikim negativ në të drejtat e njeriut të parashtruesit të ankesës. Në bazë të OPLAN-it dhe konceptit të tij llogaridhënës, i cili e obligon Misionin që të siguroj se respektohen standardet e pranuar ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut, Paneli ka përgjegjësi që të rekomandoj masa të tilla, kurdoherë që konsiderohet e domosdoshme. Mos veprimi i EULEX-it me vendosmëri dhe shpejt për të zvogëluar rrezikun e shkaktuar ndaj

parashtruesit të ankesës nga zbulimi i këtij informacioni do të merret parasysh sa i përket gjetjeve të Panelit.

V. LIGJI

24. Parashtruesi i ankesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të përcaktuara në Konventë, pasi informatat që ai i kishte ofruar EULEX-it ishin dërguar autoriteteve serbe kundër vullnetit të tij dhe pa bazë ligjore. Ai nuk pretendon se ka ndonjë kërcënim të veçantë ndaj tij apo familjes së tij, mirëpo pohon se zbulimi i atij informacioni tek autoritetet serbe mund të krijoj rreziqe serioze për të dhe familjen e tij. Prandaj kjo ankesë do të shqyrtohet sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës.
25. Në dispozitat përkatëse të Konventës, në masën sa janë përkatëse, thuhet si në vijim:

Neni 3 Ndalimi i torturës

Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ... trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni 8 E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtë në respektimit të jetës së tij private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse siç parashikohet me ligj dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, apo mirëqenies ekonomike të shtetit, për pengimin e trazirave apo krimin, për mbrojtjen e shëndetit apo moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

a. Dokumentet e paraqitura nga palët

26. Në dokumentet e para të paraqitura të datës 4 maj 2012, ShM ka pohuar se zbulimi i deklaratave të parashtruesit të ankesës tek zyra e prokurorit të Serbisë nuk është bërë kundër vullnetit të parashtruesit të ankesës, pasi ai ishte i njoftuar rreth saj dhe se ai nuk kishte kundërshtuar. Sipas ShM, parashtruesi i ankesës gjithashtu ishte njoftuar rreth mundësisë se gjykimi mund të mbahej në Serbi, përderisa disa prej të dyshuarve tashmë ishin të arrestuar në Serbi. Nuk ishte paraqitur asnjë e dhënë me shkrim prej dokumenteve përkatëse rreth këtyre çështjeve.
27. Për më tepër, ShM pohoi se ZPSK po bashkëpunonte rregullisht me homologët e tyre serbë në lidhje me hetimet që po zhvilloheshin, në veçanti në lidhje me shkëmbimet e informatave.

28. Në përgjigje ndaj vërejtjeve të ShM, parashtuesi i ankesës ka ritheksuar ankesat e tij të mëparshme. Ai pohoi se kur ia kishte ofruar informatat hetuesve të EULEX-it, ai nuk ishte i njoftuar se ajo informatë mund t'i ofrohej autoriteteve serbe dhe se ai vazhdoj të këmbëngul se ajo informatë nuk ishte dashur t'i ofrohej atyre autoriteteve.
29. Ai shprehu edhe një herë frikën rreth sigurisë së tij dhe të familjes së tij. Ai pohoj se disa të dyshuar në këtë lëndë janë ende në liri, megjithëse ai nuk e ka dhënë burimin e informatës. Ai pohoj se ishte siguruar diku në vitin 2010, se atij dhe familjes së tij do t'i ofrohej mbrojtje e afërm, mirëpo nuk është ndërmarrë asnjë hap sa i përket kësaj. Ai gjithashtu ka nënvizuar se edhe nëse do të ndërmerreshin masat e mbrojtjes, ato nuk do t'i përfshinin fëmijët e tij të mëdhenj, ku po ashtu ai ishte i shqetësuar për sigurinë e tyre.
30. Parashtuesi i ankesës pohoi se rasti duhej të hetohej nga EULEX-i dhe pastaj nga autoritetet e Kosovës. Ai ritheksoj faktin se ai dhe dëshmitarët e tjerë ende ishin të gatshëm të bashkëpunojnë me hetuesit e EULEX-it, mirëpo ata kishin kundërshtuar kryerjen e hetimeve nga ana e autoriteteve serbe, pasi nuk u besonin atyre.
31. Ai gjithashtu ka thënë se ai ka pasur kontakt të rregullt me EULEX-in, mirëpo së fundi ishte injoruar nga ta. Për shembull, ai kishte kërkuar një takim me kryeprokurorin e EULEX-it, mirëpo deri më tani pa sukses. Po ashtu, hetuesi i EULEX-it thuhet se e ka injoruar informatën që ai e ka ofruar rreth një dëshmitari të masakrës, i cili ishte marrë nga serbët për në spitalin e Pejës, e që parashtuesi i ankesës beson se ai ishte vrarë aty. Parashtuesi i ankesës nuk ka ofruar dokumentacion për të vërtetuar atë ngjarje të supozuar.
32. Në vërejtjet e tij të datës 17 janar 2013 rreth meritave të rastit, ShM ka vënë re se parashtuesi i ankesës si dëshmitarë kishte dhënë vullnetarisht një deklaratë tek autoritetet serbe dhe gjithashtu kishte konfirmuar deklaratën e tij të më mëhershme. Kjo sipas mendimit të ShM demonstroi bashkëpunimin e tij vullnetar të vazhdueshëm me autoritetet e EULEX-it dhe ato serbe. ShM për më tej ka pohuar se nëse do të kishte pasur "ndonjë shkelje teknike" të së drejtës së parashtuesit të ankesës, ai nuk do të kishte pësuar ndonjë dëm të dukshëm. Prandaj, ShM ka rekomanduar që Paneli të hedh poshtë ankesën si të pabazë.
33. Në përgjigjen ndaj vërejtjeve të ShM, parashtuesi i ankesës ka pohuar se ai në fakt nuk e ka përsërit deklaratën e tij të mëhershme, të ofruar hetuesve të EULEX-it para autoriteteve serbe. Dëshmia e tij në Kurshumli lidhet vetëm me njëfarë Z.O., i cili për momentin është në paraburgim. Në anën tjetër, dëshmia e tij fillestare ka inkriminuar disa të dyshuar të tjerë, të cilët ishin ende në liri. Ai prapë ngriti shqetësimin e tij rreth mënyrës se si EULEX-i e kishte trajtuar deklaratën e tij dhe ka këmbëngulur se si rezultat ai ka pësuar 'dëm'. Ai shtoj se ishte i vetëdijshëm rreth rrezikut që ai ballafaqohej, mirëpo

ai rrezik mund të ishte ulur shumë nëse identiteti i tij nuk do t'ju ishte zbuluar autoriteteve serbe, të cilëve siç e përsëriti prapë nuk ju besonte.

b. Vlerësimi i Panelit

34. Përsëritjet e shqetësimit nga parashtruesi i ankesës duhej ta kishin vetëdijesuar EULEX-in rreth nevojës për ta trajtuar bartjen e informatave të tij – dhe të dëshmitarëve të tjerë të shqetësuar – me një shkallë të nevojshme kujdesi dhe maturie. Për më tepër, duke marrë parasysh seriozitetin e akuzave në lidhje me atë që ai kishte ofruar atë informatë, nuk ka qenë e paarsyeshme për të që të konsideroj se zbulimi i atij informacioni mund të krijonte rrezik për sigurinë e tij apo të familjes së tij. Prapë kjo duhej ta kishte nxitur EULEX-in që të kishte kujdes të veçantë në rastin e dërgimit të atij informacioni tek ndonjë autoritet tjetër – qoftë autoritetit serb apo tjetër. Është e rëndësishme në këtë kontekst se në vërejtjet e ShM nuk është sugjeruar se ishte kryer një vlerësim i rrezikut nga EULEX-i para apo pas dërgimit të atij informacioni. Kjo jep disa shenja se nuk kishte pasur kujdes dhe zell të nevojshëm që ishin të domosdoshëm në këto rrethana.
35. Për më tepër, përmes insistimit të tij se deklarata e tij nuk duhej t'i dërgohej autoriteteve serbe dhe në mungesë të ndonjë indikacioni se ai ishte njoftuar siç duhej se ajo mund të ndodhte, parashtruesi i ankesës kishte pritje të ligjshme se nuk do të ndodhte ashtu. Duke zbuluar atë informacion pa shprehjen e miratimit të tij, apo së paku pa i dhënë atij një mundësi të drejtë për ta kundërshtuar vendimin e prokurorit që ta dërgoj atë informacion tek autoritetet serbe, prokurori i EULEX-it ka shkelur pritjen e tij të ligjshme. Nuk ka ndonjë tregues që dihet se para se ta bënin këtë, prokurorët e EULEX-it kishin kryer një vlerësim të rreziqeve për parashtruesin e ankesës nëse kjo informatë ishte komunikuar e as të nevojës për të kërkuar garancione nga autoritetet serbe lidhur me përdorimin që ata mund t'ja bënin asaj deklaratë. Prapë kjo sugjeron se kujdesi dhe maturia që do të ishin të duhura në këto rrethana nuk ishin praktikuar nga prokurorët e EULEX-it para komunikimit të deklaratës së tij tek autoritetet serbe.

Shkelje e dyshuar e nenit 3

36. Paneli e ka shqyrtuar nëse sjellja që i ngarkohet EULEX-it hyn në pragun e seriozitetit që lidhet me nenin 3 të Konventës (shih, në mesin e autoriteteve të tjera, *Akkoç kundër Turqisë*, nr. 22947/93 dhe 22948/93, ECHR 2000-X, §114). Paneli konsideron se sjellja e kontestuar e EULEX-it ka krijuar një rrezik për parashtruesin e ankesës dhe familjen e tij, e cila do të trajtohet në vijim. Paneli megjithatë vëren se parashtruesi i ankesës nuk ka sugjeruar se ky rrezik ishte konkretizuar në ndonjë formë, qoftë përmes kërcënimeve

apo dëmit të tanishëm. Në këto rrethana dhe në mungesë të informacioneve përkatëse në këtë pikë, Paneli duhet të konkludoj se veprimet e EULEX-it dhe ndikimi i tyre në parashtruesin e ankesës nuk hyjnë në pragun e seriozitetit që lidhet me atë dispozitë.

37. Përderisa parashtruesi i ankesës nuk ishte në gjendje të ofroj dëshmi konkrete rreth dëmit të tanishëm që po i bëhej apo kërcënimeve që po i bëheshin familjes së tij, rreziku se kjo mund të ndodh tregon që EULEX-i duhet të ndërmerri hapa të menjëhershëm dhe efektiv për të siguruar që një rrezik i tillë nuk do të konkretizohet.
38. Duke pasur parasysh këtë më sipër, Paneli konkludon se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

Shkelje e dyshuar e nenit 8

39. Për aq sa parashtruesi i ankesës pohon se deklarata e tij prej dëshmitari dhe të dhënat e tij personale ishin zbuluar tek autoritetet serbe pa pëlqimin e tij, Paneli vëren se grumbullimi dhe përdorimi i informatave nga zyrtarët rreth ndonjë personi pa pëlqimin e tij mund të bie ndesh me të drejtën e tij të respektimit të jetës së tij private të garantuar sipas nenit 8 të Konventës (shih *Leander kundër Suedisë, vendimi i datës 26 mars 1987, paragrafi 48*).
40. Një ndërhyje e tillë do të shkel nenin 8, përveç nëse ajo është “në përputhje me ligjin”, ndjek një apo më shumë qëllime të ligjshme të përmendura në paragrafin 2 të nenit 8 dhe për më tepër është “e nevojshme në një shoqëri demokratike” në mënyrë që të arrihen ato (shih *Petra kundër Rumanisë, vendimi i datës 23 shtator 1998, Reportet 1998-VII, fq. 2853, paragrafi 36*).
41. Së pari duke u kthyer tek çështja nëse veprimet e EULEX-it ishin “në përputhje me ligjin”, Paneli vëren se EULEX-i nuk ka arritur që ta përmend ndonjë dispozitë ligjore mbi bazën e së cilës dhënia e asaj informate autoriteteve serbe ishte bazuar.
42. Paneli vëren se duke bërë ofrimin e kësaj deklarate pa ndonjë bazë të dukshme ligjore tek autoritetet serbe, prokurorët e EULEX-it e kanë mohuar gjithë mundësinë procedurale të parashtruesit të ankesës për të kontestuar veprimet e tyre në gjykatat vendore, dhe në atë mënyrë që ai mund të kishte penguar një zbulim të tillë apo të merrte garancione procedurale, të cilat mund t'i kishin ulur disa prej shqetësimeve të tij.
43. Pamundësia e EULEX-it për të identifikuar bazën ligjore për veprimet e tij është shqetësuese, duke pasur parasysh natyrën e çështjes në fjalë, rrezikun real dhe të drejtpërdrejtë që dëshmitarët të pengohen në mjedisin e tyre dhe faktin se parashtruesi i ankesës kishte kundërshtuar në mënyrë të përsëritur që deklarata e tij të komunikohet tek autoritetet serbe.

44. Vijon nga lartë se ndërhyrja nuk ishte "në përputhje me ligjin" siç kërkohet nga paragrafi i dytë i nenit 8, dhe se ka pasur shkelje të kësaj dispozite. Në këto rrethana, një hetim i domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të mënyrës që është ndërmarrë, të thuash të drejtën, nuk është i nevojshëm. Megjithatë, në atë masë që ajo mund të ketë ndonjë ndikim në zbatimin e rekomandimeve të Panelit nga ana e EULEX-it, Paneli gjithashtu do t'i trajtojë, megjithëse shkurtimisht, kërkesat e "domosdoshmërisë", "proporcionalitetit" dhe "qëllimit legjitim".
45. Paneli ka pranuar se bashkëpunimi me autoritetet serbe e ka ndjekur qëllimin legjitim të parandalimit të çrregullimit apo krimit brenda kuptimit të paragrafit 2 të nenit 8. Hetimi dhe ndjekja penale e krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtarë është pa dyshim një qëllim i cili duhet të ndiqet në mënyrë energjike, e që në disa rrethana mund ta bëjë të nevojshme vendosjen e kufizime të të drejtave të garantuara sipas nenit 8 të Konventës.
46. Paneli tani do të shqyrtoj nëse ishte prekur ekuilibri i drejtë në mes të interesave të jetës private të parashtruesit të ankesës dhe qëllimit të ligjshëm për kryerjen e një hetimi efektiv në ato ngjarje. Sipas jurisprudencës së vendosur të Gjykatës, nocioni i domosdoshmërisë nënkupton që ndërhyrja përputhet me një "nevojë të ngutshme shoqërore" dhe në veçanti se ajo është në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur (shih, midis autoriteteve të tjera, *Olsson kundër Suedisë* (nr. 1), 24 mars 1988, paragrafi 67, Seria A nr. 130). Gjykata në përputhje me rrethanat duhet që të konstatojë nëse, në rrethanat e rastiit, zbulimi i deklaratës së parashtruesit të ankesës ka prekur ekuilibrin e drejtë midis interesave përkatëse, konkretisht të së drejtës së tij për respektimin e jetës së tij private në njërin anë, dhe parandalimin e çrregullimit dhe krimit në anën tjetër (shih, për shembull, *mutatis mutandis, Keegan kundër Irlandës*, 26 Maj 1994, paragrafi 30, Seria A nr. 290).
47. Paneli në këtë kontekst vëren se është një detyrë normale civile që personat të japin dëshmi gjatë procedurave penale (*Voskuil kundër Holandës*, nr. 64752/01, vendimi i datës 22 nëntor 2007, paragrafi 86). Gjithashtu ai e vlerëson interesin e fortë të komunitetit ndërkombëtar në zbulimin, parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve të rënda, në veçanti të krimeve të luftës. Nuk kontestohet që prirja e tanishme drejt forcimit të bashkëpunimit në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës, në parim, është në interes të personave në fjalë (shih, *mutatis mutandis, Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës*, vendimi i datës 26 qershor 1992, paragrafi 110). Sidoqoftë, siç diskutohet në vijim, përgjegjësia për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e rënda gjithashtu përfshinë përgjegjësinë e autoriteteve kompetente për t'i mbrojtur ata që ju kanë siguruar atyre informacione, p.sh. dëshmitarët.
48. Raporti shpjegues i bashkëngjitur në Rekomandim Rec(2005)9 të Komisionit të Ministrave për shtetet anëtare rreth mbrojtjes së

dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë e bën të qartë (paragrafi 26) se "detyra për të dhënë dëshmi nënkupton detyrë përkatëse për shtetin në mënyrë që të siguroj masat të cilat do të nxisin sigurinë e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë". Interesat e dëshmitarëve janë, në parim, të mbrojtura nga dispozitat thelbësore të Konventës, të cilat nënkuptojnë që procedura penale duhet të organizohet në mënyrë të tillë që këto interesa nuk rrezikohen në mënyrë të paarsyeshme. Jeta e dëshmitarit, liria apo siguria e personit mund të jetë në rrezik. (shih p.sh. *Doorson kundër Holandës*, vendimi i datës 26 mars 1996 paragrafi 70; *Van der Heijden kundër Holandës*, vendimi i datës 3 prill 2012, paragrafi 76). Përgjegjësia për mbrojtjen e dëshmitarëve mund të nënkuptoj një detyrim pozitiv nga ana e autoriteteve për të marrë masa për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e dëshmitarëve edhe pse ky detyrim nuk duhet të imponoj ndonjë barrë të pamundur apo joproporcionale mbi ta (shih p.sh. *J.L. kundër Letonisë*, Aplikacioni nr. 23893/06, vendimi i datës 17 prill 2012, në veçanti, paragrafët 68 e tutje; *Van Colle kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 7678/09, vendimi i datës 13 nëntor 2012, në veçanti paragrafët 88 e tutje; *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 87/1997/871/1083, vendimi i datës 28 tetor 1998, paragrafi 115; *R.R. dhe të Tjerët kundër Hungarisë*, Aplikacioni nr. 19400/11, vendimi i datës 4 dhjetor 2012, paragrafët 22 e tutje; shih gjithashtu Këshillin e Evropës, Komisioni i Ministrave, Rekomandimi Rec(2005)9 i Komisionit të Ministrave për shtetet anëtare rreth mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, miratuar nga Komisioni i Ministrave më 20 prill 2005, në mbledhjen e 924^{te} të zëvendës ministrave dhe Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe Shpërdorimit të Pushtetit, A/RES/40/34, 29 nëntor 1985).

49. Duke pasur parasysh seriozitetin e krimeve të dyshuara lidhur me atë çka ka ofruar informata, dhe frikën e vërtetë të shprehur nga ana e dëshmitarit dhe mjedisit të paqëndrueshëm në të cilën ai jeton, prokurorët e EULEX-it e dinin ose duhet ta ketë ditur se zbulimi i pakushtëzuar i deklaratës së tij tek autoritetet serbe potencialisht mund ta ballafaqoj parashtruesin e ankesës dhe familjen e tij me një dëm të mundshëm, e që është dashur të shmangej. Prokurorët e EULEX-it nuk kanë marrë masa në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të tyre, të cilat gjykuar në mënyrë të arsyeshme, mund që të ishin pritur prej tyre në mënyrë që të shmangnin apo ulnin këtë rrezik (shih përsëri *RR dhe të Tjerët kundër Hungarisë*, cituar më sipër, paragrafi 29; Rekomandimi Rec(2005) 9 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë: "shtetet anëtare kanë për detyrë të mbrojnë dëshmitarët kundër një ndërhyrje të tillë duke ju ofruar atyre masa të mbrojtjes së veçantë me synim që në mënyrë efektive të sigurojnë sigurinë e tyre"). Këto masa të tilla mund të kenë përfshirë, për shembull, fshirjen e tipareve identifikuese të dëshmitarit apo kërkimin e masave mbrojtëse apo urdhëresa që mos të bëhej zbulimi nga autoritetet kompetente para dërgimit të deklaratës së tij. Pra

prokurorët e EULEX-it nuk ka bërë atë që në mënyrë të arsyeshme është pritur prej tyre në këto rrethana dhe potencialisht e kanë vënë parashtruesin e ankesës dhe familjen e tij në rreziqe të paarsyeshme, të cilat është dashur që të shmangeshin (shih, gjithashtu, mutatis mutandis, *Bevacqua dhe S kundër Bullgarisë*, Aplikacioni nr. 71127/11, aktgjykimi i datës 12 shtator 2008; *A. kundër Kroacisë*, Aplikacioni 55164/08, aktgjykimi i datës 14 tetor 2010).

50. Së fundi, Paneli nuk është bindur nga argumenti se fakti që parashtruesi i anekses ka rënë dakord për të dhënë dëshmi të prokurorët serbë në shtator 2012 është dëshmi se ai, në të vërtetë, nuk ka pasur frikë nga ta. Paneli vëren se parashtruesi i ankesës, në përgjigjen e tij ndaj vërejtjeve, theksoi se ai kishte rënë dakord vetëm për të dëshmuar kundër një të dyshuari i cili ishte aktualisht në paraburgim. Ai la të kuptohej se ai kishte frikë nga hakmarrja e të dyshuarve të tjerë të cilët janë ende të lirë. Një shpjegim i tillë në këto rrethana nuk është i paarsyeshme. Për më tepër, ai është shoqëruar në këtë rast nga stafi i EULEX-it. Në çdo rast, fakti se parashtruesi i ankesës ishte bindur për ta mposhtur ngurrimin e tij dhe se ai ka bashkëpunuar me autoritetet serbe nën mbikëqyrjen e dukshme të EULEX-it në asnjë mënyrë nuk mund të zvogëlojë ankthin që ai mund në mënyrë të ligjshme ta ndjej në lidhje me atë se informacionin i tij i ishte dhënë zyrtarëve të paidentifikuar serb, të cilët, nga ana tjetër, mund ta kenë shpërndarë atë persona të tjerë.
51. Paneli konstaton se, në rrethanat e këtij rasti, qëllimi legjitim i ndjekjes penale të atyre të dyshuarve nën dyshimin se kanë kryer krime lufte nuk ishte një arsye e mjaftueshme për të arsyetuar zbulimin e deklaratës së parashtruesit të ankesës dhe të dhënave personale pa pëlqimin e tij, pa ndonjë bazë të duhur ligjore, pa mbikëqyrje gjyqësore dhe pa marrjen e asnjë mase mbrojtëse për të kufizuar rreziqet që dilnin nga zbulimi i atij informacioni.
52. Nga materiali në dispozicion të Panelit nuk duket se ishte kërkuar ndonjëherë pëlqimi nga parashtruesi i ankesës, edhe pse ajo mund të ketë ndodhur. Nuk është e pamundur që parashtruesi i ankesës, i cili në mënyrë të përsëritur theksoi gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar me hetuesin, do të kishte rënë dakord që eventualisht të zbulohej ajo deklaratë nëse do të merreshin masa të caktuara për të siguruar sigurinë e tij dhe të familjes së tij. Megjithatë, nga të dhënat në dispozicion të Panelit, nuk duket se një zgjidhje e tillë i është ofruar atij ndonjëherë ose të jetë konsideruar nga EULEX-i. Tashmë siç është vënë në dukje, nuk ka as edhe ndonjë dëshmi të regjistruar se EULEX-i ka kryer një vlerësim të rrezikut për të përcaktuar se çfarë masash mund të jenë të domosdoshme në ato rrethana për të mbrojtur interesat e parashtruesit të ankesës dhe të familjes së tij.
53. Paneli do të përsëris këtu vërejtjet e bëra në paragrafin 50 se bashkëpunimi i parashtruesit të ankesës me autoritetet serbe nuk e shfaqëson në asnjë mënyrë EULEX-in nga përgjegjësitë e veta ndaj parashtruesit të ankesës. Në veçanti, Paneli vëren se nuk ka asnjë

dëshmi të regjistruar se EULEX-it ka kryer një vlerësim të nevojës dhe proporcionalitetit të zbulimit të pakushtëzuar dhe pa asnjë lloj mbikëqyrjeje të deklaratës ku nuk janë fshirë të dhënat e ndjeshme të parashtruesit të ankesës tek autoritetet serbe.

54. Dështimi i EULEX-it për të vepruar sipas rekomandimit të Panelit që të zbatoj masat e përkohshme të sugjeruara është një tregues tjetër i pamundësisë së EULEX-it për të vepruar në përputhje me praktikën më të mirë të nevojshme në çështjet e mbrojtjes së dëshmitarëve. Duke pasur parasysh natyrën serioze të çështjes penale në fjalë, sjellja e tillë është shkak për shqetësim të madh. Paneli do të ftojë ShM që me kujdes të rishikojë pozicionin e tij në lidhje me këtë çështje dhe t'i zbatoj pa vonesë masat që janë rekomanduar më poshtë.
55. Duke pasur parasysh rrethanat e rastit, Paneli konstaton se zbulimi i pakushtëzuar i deklaratës së parashtruesit të ankesës tek autoritetet serbe përbën shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 8 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, PANELI, NJEZERI,

1. *Vlerëson* se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës;
2. *Vlerëson* se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës;
3. *Konstaton* të përshtatshme, sipas gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe të ligjit, për të bërë rekomandime tek ShM sipas Rregullës 34 të Rregullores së Punës; dhe
4. *Rekomandon* që këto veprime të ndërmerren nga ShM:
 - Një deklaratë duhet të bëhet duke pranuar se rrethanat e rastit përbëjnë shkelje të të drejtave të parashtruesit të ankesës që i ngarkohen veprimeve të EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv;
 - ShM duhet të urdhëroj që masat e mëposhtme të zbatohen pa vonesë, d.m.th:
 1. Prokurorët e EULEX-it të ngarkuar me këtë lëndë duhet të ftohen që të kërkojnë nga homologët e tyre serb t'ju kthejnë kopjet e secilit dokument që iu është ofruar atyre, e që mbajnë emrin apo përmendin parashtruesin e ankesës. Kjo përfshinë të dy deklaratat që parashtruesi i ankesës i ka dhënë EULEX-it.
 2. Prokurorët e EULEX-it të ngarkuar me këtë lëndë duhet të ftohen që të kërkojnë nga homologët e tyre serb:
 - i. Të asgjësojnë secilën kopje të bërë nga dokumentet e lartpërmendur dhe ta fshijnë emrin dhe secilën informatë në dokumentet e tjera që mund të identifikoj parashtruesin e ankesës; dhe

- ii. T'i njoftoj prokurorët e EULEX-it se kjo gjë është kryer; dhe
 - iii. Mos t'i zbulohet asnjë informatë që parashtruesi i ankesës i kishte ofruar EULEX-it ndonjë të dyshuari apo të pandehuri.
- ShM duhet të urdhëroj një vlerësim të asaj se cilat instrumente ligjore janë në dispozicion të prokurorëve të EULEX-it për të bashkëpunuar në çështjet gjyqësore dhe penale, dhe nëse baza ligjore në dispozicion përcaktohet se është jo e përshtatshme dhe e pamjaftueshme, të ndërmerren hapa të nevojshëm në përpjekje për t'i vënë në fuqi të gjitha instrumentet ligjore të nevojshme;
 - Në pritje të këtij vlerësimi, ShM duhet të udhëzoj prokurorët e EULEX-it për të mos komunikuar ndonjë informacion të dhënë nga dëshmitarët tek autoritetet - serbe apo ndonjë tjetër - pa marrë ndonjë siguri nga organet kompetente hetuese dhe prokuroriale të EULEX-it se ka bazë të nevojshme ligjore për këtë qëllim dhe që prokurorët e EULEX-it do të veprojnë në pajtim me këto kërkesa ligjore në të gjitha rrethanat;
 - ShM duhet të urdhëroj organet kompetente të EULEX-it për të kryer një vlerësim të plotë të rrezikut të shkakuar në parashtruesin e ankesës dhe / ose familjen e tij, si pasojë e dhënies së deklaratave të tij tek autoritetet serbe. Pasi kjo të bëhet dhe nëse identifikohet ndonjë rrezik, Paneli rekomandon që EULEX-i duhet të diskutoj me parashtruesin e ankesës çfarëdo hapi apo mase që mund të merret për të kufizuar dhe për të parandaluar rrezikun e dëmit.
 - ShM ftohet që të shpërndaj këtë vendim tek zyrtarët përkatës të EULEX-it, të përfshirë në hetimin dhe ndjekjen e krimeve në Kosovë, me qëllim që të siguroj se ata janë të vetëdijshëm për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre karshi dëshmitarëve nga të cilët ata marrin informacione.

Ftohet ShM të informoj Panelin lidhur me masat që ai ka ndërmend të ndërmarra në lidhje me këtë vendim deri më 31 maj 2013.

Për më tepër, ShM ftohet që deri më 31 gusht 2013 ta njoftoj Panelin dhe parashtruesin e ankesës rreth masave që janë ndërmarrë, dhe rreth rezultateve që ato kanë prodhuar, me përjashtim të vlerësimi të rrezikut të përmendur më sipër, e cila duhet nis pa vonesë.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese e Panelit